



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 2140/1 prot.

Tiranë, më 01.09.2025

Lënda: Dhënie mendimi mbi *“Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Nepalit mbi ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”*

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim *“Zyra e Komisionerit”*) ka administruar shkresën tuaj nr. 4407/2 prot., datë 26.08.2025, protokolluar me tonën me nr. 2140 prot., datë 26.08.2025, me anë të së cilës dërgoni për mendim projekt marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Nepalit mbi ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar (në vijim *“projekt marrëveshja”*), si dhe relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i materialit të dërguar, vërejmë se, gjatë zbatimit të projekt marrëveshjes, shtetet palë do të shkëmbejnë ndër të tjera, informacion, i cili përmban të dhëna personale.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit sugjeron të merren në konsideratë këto ndryshime dhe shtesa në tekstin e projekt marrëveshjes, në mënyrë që përmbajtja e saj të jetë konform ligjit nr. 124/2024 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* (në vijim *“Ligji”*).

Në nenin 16 të projekt marrëveshjes, sugjerojmë që, paragrafi hyrës, të riformulohet me këtë përmbajtje:

“Komunikimi i të dhënave personale, do të realizohet duke përdorur mjete të sigurta komunikimi dhe duhet të bëhet vetëm nëse një komunikim i tillë është i nevojshëm për zbatimin e kësaj marrëveshje nga autoritetet kompetente. Përpunimi dhe trajtimi i të dhënave personale në një rast të veçantë, do të realizohet në përputhje me legjislacionin specifik për mbrojtjen e të dhënave personale të shteteve palë të kësaj marrëveshje”.

Në vijim, duke qenë se Republika e Shqipërisë ka miratuar kuadrin ligjor të përafruar me Rregulloren e Përgjithshme 2016/679 të BE për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR), me ligjin 124/2024 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, në mënyrë që të unifikohet terminologjia e përdorur në përputhje me legjislacionin në fuqi të mbrojtjes së të dhënave

personale, si dhe në mbështetje të parashikimeve të pikës 3, të nenit 6 të Ligjit, sugjerojmë që, **germa c, e nenit 16 të projekt marrëveshjes**, të riformulohet me përmbajtje, si vijon:

“(c) të dhënat personale duhet të jenë të përshtatshme e të nevojshme për qëllimin e përpunimit dhe të kufizuara në masën që është e nevojshme për realizimin e qëllimit për të cilin janë mbledhur dhe/ose përpunuar, në veçanti, të dhënat personale të komunikuara mund të lidhen vetëm me sa më poshtë...”

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, paragrafi **në germën f, të nenit 16 të projekt marrëveshjes**, krijon paqartësi. Bazuar në parashikimet e legjislacionit shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, konkretisht në parashikimin e pikës 4, të nenit 6 të Ligjit, që nënkupton se, kur të dhënat personale rezultojnë të pasakta ose të paplota, duhet të ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm për fshirjen e korrigjimin e menjëhershëm të këtyre të dhënave.

Për këtë qëllim, sugjerojmë që, **germa f, e nenit 16 të projekt marrëveshjes**, të riformulohet, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, me përmbajtje, si vijon:

“Palët Kontraktuese, angazhohen të marrin çdo masë të nevojshme për të siguruar që përpunimi i të dhënave personale të kryhet në përputhje me legjislacionin specifik për mbrojtjen e të dhënave personale. Në rast se të dhënat personale rezultojnë të pasakta ose të paplota, në raport me qëllimin e përpunimit, secila palë merr masa për korrigjimin, fshirjen ose bllokimin e tyre dhe njofton menjëherë palën tjetër për çdo ndryshim të tillë, në funksion të garantimit të transparencës dhe respektimit të kësaj marrëveshjeje.”

Njëkohësisht, sugjerojmë që, **në nenin 16 të projekt marrëveshjes**, të parashikohet një pikë shtesë, me këtë përmbajtje:

“(iii) Palët Kontraktuese, në çdo rast, duhet të zbatojnë masat e duhura teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, duke garantuar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut, sipas parashikimeve të legjislacionit specifik për mbrojtjen e të dhënave personale të shteteve palë të kësaj marrëveshjeje”.

Me reflektimin e propozimeve të mësipërme, Zyra e Komisionerit, e vlerëson projekt marrëveshjen, të hartuar në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi